



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHQETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIN PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
TYRA FARKIVIT KANCELARIA ARCHIVA-ARCHIVE OFFICE	
Njësia Org. Org. Jedn.	Nr. Prot. Br. Prot.
01	58
Mbrojtjen e të Dhënave Personale	
Zaštita Ličnih Podataka	
Protection of Personal Data	
Nr. i faqeve No. pages:	Data Date:
	31.05.2012



Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštita Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 58/12
Datë: 31.05.2012

Në mbështetje të nenit 3,5,12 dhe nenit 49 paragrafi 1.5 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

V E N D I M

1. Këshillohet "Thirrja e Artë" që të bëj harmonizimin e rregullores së lojës me nenet 3,5,12 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Paralajmërohet "Thirrja e Artë" se në rast të mos zbatimit të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale tërheq marrjen e vendimit për ndalimin e përpunimit të të dhënave personale.
3. Afati për zbatimin e vendimit është tetë (8) ditë nga dita e pranimit të vendimit.
4. Agjencia të lajmërohet me shkrim lidhur me zbatimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Në bazë të neneve 3,5,12 Ligjit 03/L-172 të Mbrojtjes së të Dhënave Personale rregullat e lojës së "Thirrja e Artë" janë në kundërshtim me Ligjin 03/L-172 të parimet e përpunimit të të dhënave, ku të dhënat personale duhet të përpunohen pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar me tutje, të dhënat duhet të jenë të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime, gjithashtu koha e ruajtjes së të dhënave nuk duhet të tejkalojë qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar me tutje.

"Thirrja e Artë" duhet të bëjë të qartë subjekteve-pjesëmarrësve të lojës mënyrën e përpunimit të të dhënave të tyre me qëllim që subjektet-pjesëmarrësit e lojës të jenë të njoftuar lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre dhe mundësinë e dhënies së pëlqimit për përpunimin e të dhënave të tyre.

Ne kuptojmë se zbulimi i të dhënave në transmetimet televizive behet me qëllim të transparencës së lojës por kjo gjë bie ndesh me nenin 12, i cili thotë se në rast të zbulimit të të dhënave duhet të evidentohet informacioni si ne vijim "cilat të dhëna janë zbuluar, ku, kur dhe me çfarë baze ligjore".

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Zv.Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror


Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- Thirrjes së Artë
- RTV 21
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë